VENDIM
Nr.1157, datë 13.8.2008

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.475, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËS SË PRESIDENTIT, KUVENDIT DHE KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr.3, që përmendet në pikën 8 të vendimit nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në nëndarjen "Kryeministria" të shtohet emërtesa, si më poshtë vijon:

"Drejtor i njësisë së koordinimit të ndihmës së huaj II-a.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitin 2008, i miratuar për Kryeministrinë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 28.7.2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha